

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 654/21

Nr. i fq. / Br. af -06-

Data: / Datum 09.06.2021

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 , në bazë të nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 dhe në bazë të nenit 615 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Kryetari i Komunës, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve dhe detyrave specifike (Kontratë mbi Vepër)

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

1.Vendet e punës- Teknik Laborant

Numri i ekzekutuesve: Pesë (5)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës: 40 orë në javë

Paga: Sipas legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve për analiza ;

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

Detyrat dhe përgjegjësit:

-Kryejnë punët rreth marrjes së mostrave hematologjike prej pacientëve.

-Kryejnë punët rreth regjistrimit, klasifikimit, dhe shpërndarjen së rezultateve laboratorike.

-Kryen edhe punët tjera të laborantit sipas urdhrat të shefit të Sektorit të Diagnostikës dhe Kryelaborantit.

Kualifikimi profesional:

Diplomë baqelor ose shkolla e mesme

2.Vendet e punës: Infermier të Përgjithshëm

Numri i ekzekutuesve dhjetë (10)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve në infermieri

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon dhe triazon pacientët në QKMF;
 - Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore;
 - Kryen punët administrative shëndetësore;
 - Përgjigjet për participimin e pacientëve;
 - Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit;
 - Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve;
 - Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulancë dhe anasjelltas;
 - Sipas urdhrimit të Shefit të Mjekësisë Familjare kryen edhe punë të tjera;
 - Për punën e vetë i përgjigjet kryeinfermierit dhe shefit të sektorit të Mjekësisë Familjare
- Kualifikimi profesional: Bachelori i infermierisë ose shkolla e mesme e infermierisë

3.Vendet e punës: Asistent të Stomatologjisë

Numri i ekzekutuesve tre (3)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i Shërbimeve për Stomatologji

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave:

- Pranon dhe triazon pacientët në QKMF;
- Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore;
- Kryen punët administrative shëndetësore;
- Përgjigjet për participimin e pacientëve;
- Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulancë dhe anasjelltas;
- Sipas urdhrimit të Shefit të Stomatologjisë kryen edhe punë të tjera;
- Për punën e vetë i përgjigjet Shefit të Stomatologjisë.

Kualifikimi profesional: Shkolla e mesme –drejtimi i stomatologjisë.

Qendra për Punë Sociale- Vushtrri

4.Vendi i Punës: Punëtor Social

Numri i ekzekutuesve tre (3)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i këshillave nga lëmi i çështjeve sociale

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiave:

- Ndihmon në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje;
- Ndihmon në trajtimin e sjelljeve asociale të fëmijëve të cilët përdorin substanca narkotike;
- Ofron shërbime për të moshuarit;
- Trajton rastet e prostitucionit dhe të trafikimit;
- Ndihmon në kontaktimin prind- fëmijë;
- Si dhe shumë shërbime tjera në QPS

Kualifikimi profesional: Diplomë Universitare

5.Punëtor administrativ

Numri i ekzekutuesve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve administrative

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave:

-Ofron shërbime administrative për QPS

-Sistem lëndët e shërbimeve sociale dhe asistencës sociale

-Protokollon lëndët dhe krijon dosjet

-Ofron edhe shërbime tjera në QPS

Kualifikimi profesional: Diplomë Universitare

Shtëpia e Rezidenciale e komunitetit në Lumadh

6.Vendi i Punës: Infermier i Përgjithshëm

Numri i ekzekutuesve një (1)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve mjekësore

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiave:

-Pranon dhe triazhon pacientët në Shtëpinë Rezidenciale për Persona me Aftësi të Kufizuara;

-Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore;

-Kryen punët administrative shëndetësore;

-Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit;

-Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve;

Kualifikimi profesional: Baqelori i infermierisë ose shkolla e mesme e infermierisë.

7.Vendi i Punës: Ndihmës Mjekësor

Numri i ekzekutuesve një (1)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve mjekësore

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësiave:

-Ndihmon infermierët në ofrimin e shërbimeve në Shtëpinë e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara në Lumadh;

Kualifikimi profesional: Shkolla e mesme

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

1.Vendi i Punës: Ekspert për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesave për objektet të cilat nuk kanë leje ndërtimi

Numri i ekzekutuesve dhjetë (10)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Qëllimi i vendit të punës: Trajtimi i kërkesave të palëve lidhur me objektet pa leje ndërtimi

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Trajtimi i ndërtimeve pa leje dhe kompletimi i dokumentacionit ;

-Procedurat dhe kërkesat për bazën e të dhënave të legalizimit;

-Baza e të dhënave të legalizimit;

-Punë të tjera nga lëmi i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor

Kualifikimi profesional:

Diplomë Universitare, drejtimi: Inxhinier i ndërtimtarisë, arkitekturës. Në mungesë të tyre fakulteti ekonomik ose juridik.

Drejtoria për Arsim:

1.Vendi i Punës: Psikolog

Numri i ekzekutuesve shtatë(7)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësive:

-Kryen Konsultim dhe bashkëpunim

-Ndërhyrje dhe mbështetje mësimore për të zhvilluar aftësitë sociale dhe jetësore

-Shërbime parandaluse dhe të përgjegjshme

-Shërbime e bashkëpunimit në shkollat familjare

-Diversiteti në zhvillim dhe mësim

Kualifikimi profesional:

Diplomë Universitare – Psikologji

2.Vendi i punës: Logoped

Numri i ekzekutuesve dy (2)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive

-Trajton personat që kanë probleme me belbëzimin belbëzimin

-Trajton personat me të folurit e pa zhvilluar

-Të folurit me vonesë

-Ngecjet Psikomotorike (Ngecjet në zhvillim të përgjithshëm)

-Sindrom Down.

Kualifikimi profesional: Diplomë universitare drejtimi logoped

3.Vendi i punës: Edukator për Parashkollor

Numri i ekzekutuesve: gjashtë(6)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm dhe përkujdesjes së fëmijës
 - Raporton çfarëdo shqetësimi për zhvillimin edhe shëndetin e secilit fëmijë
 - Organizon takime individuale dhe grupe me prindër
 - Zbatim i punës në frymën e filozofisë dhe politikës së institucionit
 - Raportim i rregullt i dëmeve të evidentuara apo shqetësimeve tjera te drejtori.
- Kualifikimi profesional: Fakulteti i Edukimit për parashkollor.

4.Vendi i punës: Pedagog

Numri i ekzekutuesve dy (2)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Planifikon programimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore
 - Mbështet hartimin dhe zbatimin e planit zhvillimor të shkollës
 - Bënë Koordinimin e punës të aktiveve profesionale dhe planprogramin e mësimdhënësve
 - Përkrahë klubet e nxënësve këshillat e prindërve dhe këshillat tjera të shkollës
 - Ndihmon dhe udhëzon mësimdhënësit në realizimin e veprimtarisë mësimore.
- Kualifikimi profesional; Diplomë universitare dega pedagogji.

5.Vendi i punës: Mësimdhënës i gjuhës angleze për institucionet parashkollore

Numri i ekzekutuesve tre (3)

Lloji i pozitës: Punë dhe Detyra Specifike (kohëzgjatja 4 muaj)

Orari i punës; 40 orë në javë

Paga: Sipas Legjislacionit në fuqi

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Angazhohet në zhvillimin e aftësive gjuhësore tek fëmijët
 - Punon në zhvillimi i aftësive gjatë shkollimit të hershëm
 - Duhet t'i shfrytëzojnë mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion
 - Është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm dhe përkujdesjes së fëmijës
 - Duhet të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit të cilit i raporton.
- Kualifikimi profesional; Diplomë Universitare- Fakulteti i Gjuhës Angleze

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimi ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimi. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjisin: Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit, dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është dënuar dhe nën hetime. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor.



Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri